

VENDIM
Nr.283, datë 18.3.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LAÇ-KISHA E SHËN NDOUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Laç-Kisha e Shën Ndout.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen tokë/truall, 244 (dyqind e dyzet e katër) m², me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 523 136 (pesëqind e njëzet e tre mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.
 4. Ky fond të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 252 500 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 6. Shpronësimi të fillojë më 1.4.2009 dhe të përfundojë më 1.6.2009.
 7. Pronarët e përcaktuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmimi ZRPP”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë verifikimet për përputhshmërinë e sipërfaqeve, të cilat preken, me numrat e pasurive, në pronësi të pronarëve, që shpronësohen.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“LAÇ-KISHA E LAÇIT”

Nr.	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe (m²)	Çmimi për (m²)	Vlera	Shënime
1	Bashkëpronarët Zymaj	2304	4/635	Truall	180	2144	385920	Konf.ZVRrPP
2	Marin Mark Zymaj	2364	4/641	Truall	64	2144	137216	Konf.ZVRrPP